



Kryetar i Këshillit Drejtues  
Muharrem Nitaj

Nr. Prot.: 3/571  
Datë: 23/12/2013

Në bazë të nenit 13, pika 1.14 të Statutit të UP-së, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 19.12.2013, miratoi:

## **RREGULLOREN** **e Institutit të Matematikës, Statistikës dhe Shkencës** **Kompjuterike**

### **Neni 1** **Dispozitat e përgjithshme**

1.1. Instituti i Matematikës, Statistikës dhe Shkencës Kompjuterike është institut i themeluar në kuadër të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN), nga Universiteti i Prishtinës, në bazë të Rregulores 2/513 (dt. 25.10. 2013) të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës.

### **Neni 2** **Qëllimi dhe veprimtaria e Institutit**

2.1. Qëllimi i Institutit është:

2.1.1. Ta avancojë matematikën, statistikën dhe shkencën kompjuterike (MSShK), përfshirë Teknologjinë Informativë dhe Komunikuese (TIK).

2.1.2. T'i zhvillojë kapacitetet njerëzore në UP dhe më gjerë për veprimtari shkencore-kërkimore në MSShK.

2.1.3. Ta realizojë dhe promovojë zbatimin e MSShK në ekonomi dhe veprimtari të ndryshme shoqërore.

2.1.4 Ta avancojë infrastrukturën për punë kërkimore-shkencore dhe për ofrimin e shërbimeve në fushat MSShK.

2.1.5 Ta fuqizojë ndërkombëtarizimin e veprimtarive shkencore-kërkimore në fushat e MSShK.

2.2 Për ta realizuar qëllimin nga ky nen, Instituti merret me veprimtaritë e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në këto:

2.2.1 Do të realizojë dhe mbështes hulumtimet shkencore në matematikë, statistikë dhe shkencë kompjuterike.

2.2.2. Do të realizojë dhe promovojë studime interdisiplinare ku gjen zbatim të drejtpërdrejtë matematika, statistika apo shkenca kompjuterike (përfshirë TIK).

2.2.3. Ta realizojë dhe promovojë përdorimin e TIK në adresimin e problemeve mjedisore e sociale, si dhe në nivele zyrtare (ekonomi, sistem arsimor, sistem shëndetësor, administratë publike, etj.).

2.2.4. Do të përgatis dhe ofrojë analiza dhe realizojë hulumtime dhe sondazhe, duke u bazuar në metoda statistikore.

2.2.5. Do të ofrojë shërbime të përgatitjes së softuerëve kompjuterikë.

2.2.6. Do të organizojë dhe mbështes seminarat, konferencat, punëtoritë, trajnimet, forumet dhe format e tjera të organizimeve publike.

2.2.7. Do të ndihmojë publikimin dhe blerjen e revistave, librave, e materialeve të tjera shkencore e profesionale.

2.2.8. Do të ndërtojë bashkëpunim shkencor-profesional me institutet, institucionet, dhe organizatat apo individët brenda dhe jashtë vendit.

### **Neni 3**

#### **Organet e Institutit**

3.1. Organet e Institutit janë:

3.1.1. Këshilli i Institutit;

3.1.2. Drejtori i Institutit;

3.1.3. Sekretari i Institutit.

3.2. Nëse Instituti e zgjeron punën e vet dhe angazhimet, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, në bazë të kërkesës së arsyetuar të Institutit, mund të lejojë shtimin e numrit të stafit.

### **Neni 4**

#### **Këshilli i Institutit**

4.1. Këshilli i Institutit përbëhet nga pesë anëtarë:

4.1.1 Prorektori për kërkime shkencore ose ndonjë përfaqësues tjetër i caktuar nga rektori i UP-së;

4.1.2. Prodekani i FSHMN-së për çështje mësimore;

4.1.3. Shefi i Departamentit të Matematikës;

4.1.4. Një anëtar i stafit akademik të Departamentit të Matematikës, i zgjedhur nga stafi i Departamentit të Matematikës; dhe

4.1.5. Një anëtar i jashtëm, nga komuniteti akademik, i biznesit apo ndërmarrësisë, nga Kosova apo jashtë saj, i propozuar nga Shefi i Departamentit të Matematikës dhe i miratuar nga Dekani i FSHMN-së.

4.2. Anëtarët e Këshillit kanë mandat 4 vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.

4.3. Këshilli e zgjedh Kryesuesin nga radhët e veta.

4.4. Kryesuesi i thërret dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit.

- 4.5. Vendimet në Këshill merren me shumicë votash (të të gjithë anëtarëve).
- 4.6. Drejtori i Institutit është anëtar i Këshillit të Institutit, por pa të drejtë vote.

## **Neni 5**

### **Drejtori dhe Sekretari i Institutit**

- 5.1. Institutin e udhëheq Drejtori i tij, i cili është përgjegjës për të gjithë aktivitetin e tij hulumtues-shkencor dhe publikues.
- 5.2. Drejtori i Institutit zgjidhet nga Këshilli i Institutit, me mandat 4 vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje.
- 5.3. Drejtori është nga radhët e stafit akademik të Departamentit të Matematikës, FSHMN.
- 5.4. Në punën e tij, Drejtori përkrahet nga Sekretari i Institutit, i cili propozohet nga Drejtori dhe aprovohet nga Këshilli i Institutit.
- 5.5. Sekretari duhet të jetë nga radhët e stafit akademik të Departamentit të Matematikës.
- 5.6. Drejtori dhe Sekretari duhet të përkujdesen për informimin, aranzhimin e takimeve, konferencave dhe të kryejnë punë të tjera të nevojshme, me përkushtimin e që sa më shumë ta angazhojnë stafin e Departamentit të Matematikës dhe FSHMN-së.

## **Neni 6**

### **Financimi**

- 6.1. Aktivitetet e Institutit mund të financohen nga burimet vijuese:
- 6.1.1. Nga fondet publike, përfshirë UP-në;
- 6.1.2. Nga projektet;
- 6.1.3. Nga aktiviteti vetjak;
- 6.1.4. Nga donacionet
- 6.1.5. Nga burime të tjera, në përputhje me ligjin dhe Statutin.

## **Neni 7**

### **Raportimi dhe llogaridhënia**

- 7.1. Në fillim të çdo viti kalendarik, Drejtori i Institutit e prezanton raportin vjetor për vitin e mbaruar akademik dhe planin vjetor për vitin vijues akademik para Këshillit të Institutit, në lidhje me aktivitetet e Institutit.
- 7.2. Këshilli voton për ta aprovuar Raportin vjetor dhe ndaras voton për planin vjetor.
- 7.3. Kryesuesi i Këshillit ia dorëzon raportin vjetor dhe planin vjetor të miratuar Dekanit të FSHMN-së.
- 7.4. Dekani i FSHMN-së i procedon dokumentet nga 7.3. për miratim në Rektorat (te prorektori për shkencë) dhe në Këshillin Drejtues.
- 7.5. Këshilli Drejtues i shqyrton për miratim dokumentet nga 7.4. Në kuadër të shqyrtimit Këshilli Drejtues e fton prorektorin për kërkime shkencore për konsultim.



**Neni 8**  
**Kontraktimi i punëve**

8.1. Kontraktimi i punëve bëhet në bazë të Nenit 7 të Rregullores 2/513 (dt. 25.10.2013) të Këshillit Drejtues.

**Neni 9**  
**Ndarja e mjeteve të realizuara dhe pagesa për punën e kryer**

9.1. Ndarja e mjeteve të realizuara dhe pagesa për punën e kryer bëhet në bazë të Nenit 8 të Rregullores 2/513 (dt. 25.10.2013) të Këshillit Drejtues.

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga kryetari i Këshillit Drejtues të UP-së.



Kryetari i Këshillit Drejtues të UP-së

Muharrem Nitaj